

Nr. _____ prot

Tiranë, _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Ofrimi i shërbimit të hemodializës në 5 (pesë) qendra të hemodializës, të ngritura në spitalet Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan, Marrëveshje Kuadër 48 muaj”.

KODI SIPAS FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 85111900-9
“Shërbime dializash spitalore”

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-96313-08-14-2026

FONDI LIMIT TOTAL/VLERA E PRITSHME E KONTRATËS: 4,591,430,480 (katër miliard e pesëqind e nëntëdhjetë e një milion e katërqind e tridhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë)
Lek pa TVSH ose 49,449,978.24 (dyzet e nëntë milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë njëzet e katër) **Euro pa TVSH Euro pa TVSH.**

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14.08.2026 është 92.85 Lekë.

Mbështetur në nenin 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”; nenin 35 “Studimi paraprak i tregut”; nenin 36 “Specifikimet teknike”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në nenin 2, pika 2/c, nenin 41 “Kërkesa të vecanta për kontratat e shërbimeve”; nenin 76 “Mënyra për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit”, të Vendimit Nr. 285, datë 19.05.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullavë të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 83 “Sigurimi i ofertës” i LPP-së në të cilën është e përcaktuar se: “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit”, i LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 “Kriteret e kualifikimit/pjesëmarrjes” të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar në marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet se: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar në marrëveshjes kuadër, të objektit që prokurohet është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të shërbimeve të hemodializës ose shërbimeve tërësisht të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % e vlerës së parashikuar në marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës së parashikuar në marrëveshjes kuadër, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën (e vlefshme) **ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent** në përputhje e objektin e prokurimit e cila

të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojnë ofertuesve të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në pikën 1 të nenit 44 “Kërkesat e cilësisë “të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: 1. “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të kryer shërbime dhe që janë vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me certifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që shërbimi të kryhet me cilësi sipas certifikatës ISO të mësipërme.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, datë 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se disponon dhe do të vërë në dispozicion, personelin e nevojshëm, të kualifikuar dhe me përvojën profesionale të përshtatshme për realizimin e shërbimit të hemodializës në të 5 (pesë) qendrat e ofrimit të shërbimit.

a) Të ketë ne stafin e tij të punësuar ose me kontratë:

- 5 (pesë) mjek nefrolog, i cili të ketë eksperiencë në këtë profesion mbi 5 vjet. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratë individuale pune/shërbimi ose marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me mjekun nefrolog; diplomë, librezë pune; licensë profesionale;
- 1 (një) infermier për çdo 4 (katër) pacientë në turn, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në ofrimin e shërbimit të hemodializës. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratë individuale pune/shërbimi ose marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme; diplomë, librezë pune; dokumentacioni që provon kualifikimin profesional, licencimin, trajnimin në hemodializë, përvojën profesionale;

- Ekip multidisiplinar mbështetës për cdo qendër, me kontratë me kohë të pjesshme, sipas specialiteteve:
 - Mjek kardiolog;
 - Psikolog;
 - Dietolog/nutricionist;
 - Reanimator.

Për të provuar këtë kriter Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratë individuale pune/shërbimi ose marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme; diplomë, licensë profesionale

Argumentimi: Bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në pikat 4/b dhe 4/c të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë dhe do të vënë në dispozicion personelin e nevojshëm, të kualifikuar dhe me përvojën profesionale të përshtatshme për realizimin e objektit të prokurimit. Kërkesa për disponimin e personelit është përcaktuar bazuar në natyrën dhe kompleksitetin e shërbimit të hemodializës, specifikimet teknike dhe termat e referencës, si dhe në nevojën për garantimin e ofrimit të shërbimit në mënyrë të vazhdueshme, të sigurt dhe cilësore në 5 (pesë) qendrat e hemodializës, të ngritura në spitalet Shkodër, Lezhë, Korçë, Vlorë dhe Elbasan. Shërbimi i hemodializës është një shërbim shëndetësor i specializuar dhe i vazhdueshëm, i cili lidhet drejtpërdrejt me trajtimin dhe sigurinë e pacientëve. Për këtë arsye, realizimi i tij kërkon disponimin e personelit mjekësor, infermieror, teknik dhe mbështetës me kualifikimet, licencimet, trajnimet dhe përvojën profesionale të nevojshme, në përputhje me kërkesat ligjore dhe profesionale në fuqi. Kërkesa për mjek nefrolog për secilën qendër lidhet me nevojën për mbikëqyrje dhe drejtim mjekësor të shërbimit të hemodializës, vlerësimin e gjendjes së pacientëve, përcaktimin dhe ndjekjen e trajtimit, si dhe marrjen e masave të nevojshme në rast të komplikacioneve gjatë procesit të dializës. Disponueshmëria e mjekut nefrolog në secilën qendër është e nevojshme për garantimin e vazhdimësisë dhe sigurisë së trajtimit. Kërkesa për staf infermieror të trajnuar dhe me përvojë në hemodializë është përcaktuar duke marrë në konsideratë se infermieri është pjesë thelbësore e procesit të ofrimit të shërbimit dhe përgjegjës për monitorimin e vazhdueshëm të pacientit gjatë seancës së hemodializës, përgatitjen dhe ndjekjen e procedurës, si dhe evidentimin dhe raportimin e çdo ndryshimi në gjendjen e pacientit. Përcaktimi i raportit minimal 1 (një) infermier për çdo 4 (katër) pacientë në turn bazohet në nevojën për të garantuar monitorim të vazhdueshëm dhe efektiv të pacientëve gjatë seancës së hemodializës, për të siguruar reagim të shpejtë të personelit në rast të komplikacioneve apo situatave të paparashikuara, si dhe duke ju referuar përcaktimeve të protokolleve të miratuara, Vendimi Nr. 308, datë 21.05.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor”, i ndryshuar me Vendimin Nr. 373, datë 26.04.2017, të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 326, datë 19.07.2017 “Për miratimin e protokolleve mjekësore të realizimit të paketave të shërbimit që financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Ky raport synon të garantojë një nivel të përshtatshëm të sigurisë dhe cilësisë së shërbimit, duke marrë në konsideratë natyrën e specializuar të procedurës. Po në referim të këtyre protokolleve është kërkuar dhe pasja e një ekipi multidisiplinar mbështetës për cdo qendër, me kontratë me kohë të pjesshme, sipas specialiteteve: Mjek kardiolog; Psikolog; Dietolog/nutricionist; Reanimator.

Gjithashtu, kërkesa që operatori ekonomik të sigurojë numër të mjaftueshëm personeli në të 5 (pesë) qendrat, si dhe të garantojë zëvendësimin në kohë të personelit në rast mungese, lidhet drejtpërdrejt me karakterin e vazhdueshëm të shërbimit dhe të rëndësisë jetike të tij. Mungesa e personelit të nevojshëm nuk duhet të sjellë ndërprerjen, shtyrjen apo cenimin e seancave të hemodializës dhe, për rrjedhojë, të ndikojë në trajtimin e pacientëve që trajtohen me hemodializë. Kërkesa për paraqitjen e dokumentacionit që provon arsimin, kualifikimin profesional, licencimin, trajnimet, përvojën dhe disponueshmërinë e personelit shërben si dëshmi për përmbushjen e kriterit dhe për të garantuar se operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale të kërkuara për realizimin e shërbimit. Kriteret e mësipërme janë përcaktuar në funksion të proceseve konkrete të punës, kompleksitetit të shërbimit, numrit të qendrave, nevojës për mbulim të vazhdueshëm të tyre dhe kërkesës për garantimin e sigurisë së pacientëve, dhe konsiderohen si kërkesa minimale të nevojshme për realizimin e kontratës. Këto kërkesa janë në proporcion me shërbimin objekt prokurimi dhe nuk kufizojnë konkurrencën për këtë procedurë prokurimi.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion (certifikatë pronësie, leje qarkullimi, kontroll fizik) që provon se disponon mjet për ofrimin e shërbimit të transportit mjekësor me autoambulancë ose të paraqesë kontratë/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me një operator ekonomik të licencuar dhe të autorizuar, për të garantuar disponueshmërinë e shërbimit të transportit mjekësor me autoambulancë, për rastet kur lind nevoja gjatë ofrimit të shërbimit të hemodializës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, dhe lidhet me nevojën për të garantuar kapacitetet teknike kur paraqitet e nevojshme. Shërbimi i hemodializës është një shërbim shëndetësor i specializuar dhe jetik, gjatë të cilit pacientët mund të paraqesin situata të papritura shëndetësore që kërkojnë vlerësim dhe ndërhyrje të menjëhershme mjekësore dhe, kur është e nevojshme, transport drejt një institucioni shëndetësor të përshtatshëm. Për këtë arsye, disponueshmëria e një shërbimi të transportit mjekësor me autoambulancë përbën një masë të nevojshme për garantimin e sigurisë së pacientëve në raste të paparashikuara. Legjislacioni shqiptar parashikon kuadrin për licencat, autorizimet dhe lejet, ndërsa shërbimet e urgjencës mjekësore përfshijnë edhe ofrimin e transportit të sigurt të pacientit drejt institucioneve shëndetësore. Kërkesa për disponimin e një mjeti autoambulancë apo një kontrate/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me një operator ekonomik të licencuar dhe të autorizuar gjatë gjithë periudhës së kontratës, synon të garantojë disponueshmërinë reale dhe të vazhdueshme të shërbimit, duke shmangur situatat në të cilat operatori ekonomik do të gjendej pa mundësi të sigurojë transportin mjekësor në një rast urgjent. Gjithashtu, përcaktimi i këtij detyrimi në DST është i nevojshëm për të siguruar që Operatori Ekonomik të ketë marrë paraprakisht masat organizative për përballimin e situatave të paparashikuara, pa cenuar vijimësinë e shërbimit të hemodializës dhe sigurinë e pacientëve. Kjo kërkesë nuk synon kufizimin e konkurrencës, pasi Operatori Ekonomik mund ta sigurojë këtë kapacitet nëpërmjet burimeve të veta ose nëpërmjet një operatori të tretë të specializuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në çdo rast, përgjegjësia për garantimin e disponueshmërisë së këtij shërbimi dhe për përmbushjen e detyrimeve kontraktore mbetet te Operatori Ekonomik kontraktues. Për sa më sipër, kriteri konsiderohet i nevojshëm dhe proporcional me objektin e prokurimit, pasi lidhet drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit të hemodializës, sigurinë e pacientëve dhe nevojën për reagim të shpejtë në rastet kur gjendja e pacientit kërkon transport mjekësor.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratë/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me një subjekt të specializuar dhe të autorizuar për mirëmbajtjen, servisimin dhe asistencën teknike të pajisjeve të hemodializës Surdial 55 dhe Surdial X, me qëllim garantimin e funksionimit të tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Nëpërmjet kërkesës ndaj operatorëve ekonomikë ofertues për të paraqitur kontratë/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me një subjekt të specializuar dhe të autorizuar për mirëmbajtjen, servisimin dhe asistencën teknike të pajisjeve të hemodializës Surdial 55 dhe Surdial X, bëhet e mundur garantimi i funksionimit të vazhdueshëm, të sigurt dhe teknikisht të përshtatshëm të pajisjeve të cilat do të përdoren për realizimin e shërbimit të hemodializës. Duke qenë se objekt i kontratës është ofrimi i shërbimit të hemodializës dhe pajisjet Surdial 55 dhe Surdial X do t’i jepen operatorit ekonomik nga Autoriteti Kontraktor dhe do të përdoren për realizimin e këtij shërbimi, funksionimi i tyre i rregullt përbën një element thelbësor për realizimin e kontratës. Çdo defekt, avari apo mosfunksionim i pajisjeve mund të ndikojë drejtpërdrejt në zhvillimin e seancave të planifikuara të hemodializës dhe në vazhdimësinë e trajtimit të pacientëve. Kërkesa për një subjekt të specializuar dhe të autorizuar synon të garantojë që mirëmbajtja, servisi dhe asistenca teknike e pajisjeve të kryhen nga persona/subjekte që disponojnë njohuritë, kompetencat dhe përvojën e nevojshme për ndërhyrjen në këto pajisje specifike. Pajisjet e hemodializës janë pajisje mjekësore të specializuara dhe ndërhyrjet teknike mbi to kërkojnë njohuri të përshtatshme për karakteristikat dhe funksionimin e tyre. Mirëmbajtja periodike dhe parandaluese e pajisjeve është e nevojshme për identifikimin në kohë të problematikave teknike, reduktimin e riskut të avarive dhe garantimin e funksionimit të tyre sipas parametrave të përcaktuar. Në të njëjtën kohë, disponimi i asistencës teknike në rast defekti mundëson ndërhyrje në kohë për rikthimin e pajisjeve në gjendje pune dhe minimizon kohën e ndërprerjes së aktivitetit të tyre. Kontrata/marrëveshja e bashkëpunimit shërben si dëshmi se Operatori Ekonomik ka siguruar paraprakisht një kapacitet teknik të disponueshëm për mirëmbajtjen, servisimin dhe asistencën e pajisjeve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Kjo siguron që mbështetja teknike të mos mbetet vetëm një angazhim deklarativ, por të mbështetet në një marrëdhënie konkrete dhe të vlefshme me një subjekt të specializuar. Subjekti i angazhuar për mirëmbajtjen dhe asistencën teknike duhet të plotësojë kërkesat ligjore për ushtrimin e aktivitetit përkatës dhe të disponojë kapacitetet profesionale dhe teknike të nevojshme për pajisjet objekt të mirëmbajtjes. Në këtë mënyrë garantohej që ndërhyrjet teknike të kryhen nga subjekte kompetente dhe në përputhje me kërkesat e sigurisë dhe funksionimit të pajisjeve mjekësore.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë licencat/autorizimet përkatëse për trajtimin e mbetjeve mjekësore të gjeneruara gjatë ofrimit të shërbimit të hemodializës ose, në alternativë, të paraqesë dokumentacionin (kontratë/marrëveshje bashkëpunimi dhe licensën) që provon që këtë shërbim do ta kryejë nëpërmjet një operatori ekonomik të tretë, të licencuar dhe të autorizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit 77, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit objekt prokurimi dhe detyrimin për garantimin e administrimit të sigurt, të ligjshëm dhe të kontrolluar të mbetjeve mjekësore të gjeneruara gjatë ofrimit të

shërbimit të hemodializës. Gjatë ofrimit të shërbimit të hemodializës gjenerohen mbetje mjekësore të cilat, për shkak të natyrës së tyre, mund të përmbajnë materiale të kontaminuara me gjak dhe lëngje biologjike, materiale njëpërdorimshme të përdorura gjatë seancave të dializës, materiale të mprehta, si dhe kategori të tjera mbetjesh që kërkojnë administrim të posaçëm. Për këtë arsye, menaxhimi, grumbullimi, magazinimi i përkohshëm, transporti, trajtimi dhe asgjësimi i tyre duhet të kryhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve mjekësore. Kërkesa që Operatori Ekonomik të jetë i pajisur me licencat dhe/ose autorizimet përkatëse për ushtrimin e aktivitetit lidhet me nevojën për të garantuar që aktivitetet që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve mjekësore të kryhen nga subjekte që plotësojnë kërkesat ligjore dhe profesionale të përcaktuara për këtë qëllim. Disponimi i licencave/autorizimeve përkatëse shërben si dëshmi se operatori ekonomik ka të drejtën ligjore dhe kapacitetin për të ushtruar aktivitetin përkatës. Në rastin kur Operatori Ekonomik nuk e realizon drejtpërdrejt këtë aktivitet, është parashikuar mundësia që shërbimi të sigurohet nëpërmjet një operatori ekonomik të tretë, i cili duhet të jetë i licencuar dhe i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi. Kjo alternativë është përcaktuar me qëllim që të mos kufizohet në mënyrë të panevojshme pjesëmarrja në procedurën e prokurimit dhe njëkohësisht të garantohet që të gjitha aktivitetet që lidhen me menaxhimin dhe trajtimin e mbetjeve mjekësore do të kryhen nga një subjekt i kualifikuar dhe i autorizuar.

Kërkesa është në përputhje me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, VKM Nr. 232 datë 01.04.2026 “Për miratimin e kërkesave, procedurave dhe standardeve për menaxhimin e mbetjeve spitalore”, si dhe me aktet nënligjore që rregullojnë administrimin e mbetjeve spitalore dhe mbetjeve që krijohen nga aktivitetet e kujdesit shëndetësor. Në referim të këtij parashikimi ligjor, operatori ekonomik duhet të sigurojë që mbetjet e gjeneruara gjatë ofrimit të shërbimit të menaxhohen në mënyrë të tillë që të shmanget rreziku për shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që dëshmon se disponon kapacitetet profesionale dhe teknike për mirëmbajtjen dhe servisimin e sistemit të trajtimit dhe parafiltrimit të ujit (certifikime, dëshmi kualifikimi), ose, në alternativë, të paraqesë dokumentacionin (kontratë/marrëveshje bashkëpunimi dhe licensën) që provon që këtë shërbim do ta kryejë nëpërmjet një operatori ekonomik të tretë, të specializuar dhe të licencuar/autorizuar për këtë shërbim, sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit 77, pika 1/c të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë natyrën e specializuar të shërbimit të hemodializës dhe nevojën për garantimin e funksionimit të sigurt, të vazhdueshëm dhe në përputhje me kërkesat teknike të sistemit të trajtimit dhe parafiltrimit të ujit. Sistemi i trajtimit dhe parafiltrimit të ujit përbën një komponent të rëndësishëm të infrastrukturës teknike të nevojshme për realizimin e shërbimit të hemodializës, pasi cilësia dhe siguria e ujit të përdorur në procesin e dializës janë të lidhura drejtpërdrejt me sigurinë e procesit të trajtimit dhe të pacientëve që i nënshtrohen seancave të hemodializës. Për këtë arsye, funksionimi i rregullt dhe mirëmbajtja periodike e këtij sistemi janë të domosdoshme për garantimin e vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimit. Kërkesa që Operatori Ekonomik të paraqesë dokumentacion (certifikime, dëshmi kualifikimi), që dëshmon disponimin e kapaciteteve profesionale dhe teknike për kryerjen e mirëmbajtjes dhe servisimit të sistemit të trajtimit dhe parafiltrimit të ujit është përcaktuar me qëllim që të garantohet se shërbimi do të realizohet nga

personel dhe subjekte që disponojnë njohuritë, kompetencat profesionale, përvojën dhe mjetet teknike të nevojshme për ndërhyrjet në këtë sistem. Mirëmbajtja dhe servisi i sistemit kërkon njohuri dhe kompetenca teknike të përshtatshme për kontrollin e komponentëve të sistemit, identifikimin e problematikave dhe defekteve, kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme teknike, zëvendësimin ose rregullimin e komponentëve, si dhe verifikimin e funksionimit të sistemit pas ndërhyrjeve. Për këtë arsye, disponimi i kapaciteteve profesionale dhe teknike përbën një element të domosdoshëm për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara të cilësisë. Kërkesa për mundësinë e sigurimit të këtij shërbimi nëpërmjet një operatori ekonomik të specializuar dhe të licencuar/autorizuar është përcaktuar në alternativë, me qëllim që operatorët ekonomikë të cilët nuk disponojnë drejtpërdrejt kapacitetet e nevojshme teknike dhe profesionale të kenë mundësi t'i sigurojnë ato nëpërmjet një subjekti të specializuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për sa më sipër, kërkesa për disponimin e kapaciteteve profesionale dhe teknike për mirëmbajtjen dhe servisin e sistemit të trajtimit dhe parafiltrimit të ujit, ose sigurimin e këtij shërbimi nëpërmjet një operatori ekonomik të specializuar dhe të licencuar/autorizuar, konsiderohet e nevojshme, e përshtatshme dhe proporcionale me objektin e prokurimit, pasi garanton funksionimin e qëndrueshëm të infrastrukturës teknike të nevojshme për ofrimin e shërbimit të hemodializës, minimizon riskun e ndërprerjes së shërbimit dhe kontribuon në garantimin e sigurisë dhe cilësisë së trajtimit të pacientëve.

2.3.8 Operatori ekonomik me anë të një deklarate duhet të deklarojë se pas kryerjes së shërbimit të hemodializës në qendrat e saj, do të bëjë dezinfektimin e ambientit dhe të paisjeve nga ku do të tërhiqen mbetjet mjeksore që gjenerohen nga ky shërbim.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se, pas përfundimit të seancave të hemodializës dhe kryerjes së procesit të largimit të mbetjeve mjeksore të gjeneruara nga ky shërbim, do të kryejnë dezinfektimin e ambienteve dhe pajisjeve përkatëse, në përputhje me kërkesat teknike, higjieno-sanitare dhe legjislacionin në fuqi. Kjo kërkesë është e nevojshme për të garantuar higjienën, sigurinë biologjike dhe parandalimin e përhapjes së mikroorganizmave dhe infeksioneve, duke marrë në konsideratë natyrën e shërbimit të hemodializës dhe kontaktin e vazhdueshëm të pacientëve dhe personelit me pajisjet dhe ambientet e qendrës. Operatori ekonomik, nëpërmjet deklaratës së paraqitur, duhet të marrë përsipër që dezinfektimi të kryhet në mënyrë të rregullt dhe pas çdo procesi të largimit të mbetjeve mjeksore, duke përdorur produkte dhe metoda dezinfektimi të përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike në fuqi si dhe protokollet e miratuara, me qëllim garantimin e kushteve të sigurta dhe higjieno-sanitare për pacientët dhe personelin.

2.3.9 Operatori Ekonomik me anë të një deklarate duhet të deklarojë se garanton zëvendësimin në kohë të personelit, në rast mungese, pamundësie të përkohshme për të ushtruar detyrën apo çdo rrethane tjetër që mund të ndikojë në vazhdimësinë e shërbimit, në mënyrë që mungesa e një anëtari të stafit të mos sjellë ndërprerje apo cenim të ofrimit të shërbimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në bazë të nenit 77, pika 1 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë natyrën e specializuar, të vazhdueshme dhe të ndjeshme të shërbimit të hemodializës dhe nevojën për garantimin e disponueshmërisë së vazhdueshme të personelit të nevojshëm për

realizimin e tij. Shërbimi i hemodializës është një shërbim shëndetësor i specializuar, i cili kërkon praninë dhe angazhimin e vazhdueshëm të personelit mjekësor, infermieror, teknik dhe mbështetës, sipas funksioneve dhe përgjegjësi të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në legjislacionin në fuqi. Për shkak të natyrës së këtij shërbimi dhe faktit që trajtimi i pacientëve realizohet në mënyrë të planifikuar dhe të përsëritur, mungesa e personelit të nevojshëm mund të ndikojë drejtpërdrejt në vijimësinë dhe cilësinë e shërbimit. Kërkesa që Operatori Ekonomik të deklarojë se garanton zëvendësimin në kohë të personelit është përcaktuar me qëllim që, në rast mungese, pamundësie të përkohshme për të ushtruar detyrën, pushimi, sëmundjeje, largimi apo çdo rrethane tjetër që mund të pengojë personelin e deklaruar në kryerjen e detyrës, shërbimi të vijojë pa ndërprerje dhe pa cenuar standardet e përcaktuara për ofrimin e tij. Zëvendësimi i personelit duhet të realizohet me persona që plotësojnë të njëjtat kërkesa të përcaktuara në dokumentet e tenderit për funksionin përkatës, përfshirë, sipas rastit, kërkesat për arsimin, kualifikimin profesional, licencimin, certifikimet, trajnimet dhe përvojën profesionale. Në këtë mënyrë, zëvendësimi nuk duhet të sjellë ulje të nivelit të kualifikimit apo cenim të cilësisë së shërbimit. Kjo kërkesë është veçanërisht e rëndësishme për personelin mjekësor dhe infermieror, të cilët kanë rol të drejtpërdrejtë në monitorimin dhe trajtimin e pacientëve gjatë seancave të hemodializës. Gjithashtu, disponueshmëria e personelit teknik është e nevojshme për garantimin e funksionimit të pajisjeve dhe sistemeve të nevojshme për ofrimin e shërbimit. Për këtë arsye, mungesa e një anëtarit të stafit nuk duhet të krijojë një situatë që pengon ose vonon ofrimin e shërbimit.

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë se disponon kapacitetet profesionale dhe organizative për menaxhimin e situatave emergjente që mund të ndodhin gjatë seancës së hemodializës, duke garantuar personel të trajnuar, pajisjet dhe barnat e nevojshme për ndërhyrjen fillestare dhe referimin e pacientit në strukturën shëndetësore përkatëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Nëpërmjet kërkesës ndaj operatorëve ekonomikë ofertues për të deklaruar se disponojnë kapacitetet profesionale dhe organizative për menaxhimin e situatave emergjente gjatë seancave të hemodializës, bëhet e mundur garantimi i reagimit të menjëhershëm dhe të përshtatshëm të personelit në rast të shfaqjes së komplikacioneve apo situatave të paparashikuara gjatë trajtimit të pacientëve. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me ofrimin e shërbimit të hemodializës, i cili është një shërbim shëndetësor i specializuar dhe gjatë të cilit pacientët mund të paraqesin komplikacione apo ndryshime të menjëhershme të gjendjes shëndetësore, është e domosdoshme që operatori ekonomik të ketë kapacitetet e nevojshme për ndërhyrjen fillestare dhe menaxhimin e situatës deri në marrjen e mëtejshme të kujdesit shëndetësor. Kërkesa për personel të trajnuar synon të garantojë që personat e angazhuar në ofrimin e shërbimit të kenë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të identifikuar në kohë situatat emergjente, për të ndërmarrë masat fillestare të nevojshme dhe për të zbatuar procedurat përkatëse të reagimit dhe referimit të pacientit. Gjithashtu, kërkesa për disponimin e pajisjeve dhe barnave të nevojshme për ndërhyrjen fillestare lidhet me nevojën për të garantuar që operatori ekonomik të jetë në gjendje të reagojë në mënyrë të menjëhershme në rast emergjence, duke reduktuar riskun e vonësive dhe duke mundësuar stabilizimin fillestar të pacientit, sipas kompetencave profesionale dhe protokolleve përkatëse. Referimi i pacientit në strukturën shëndetësore përkatëse është pjesë e rëndësishme e menaxhimit të situatave emergjente dhe synon të sigurojë vijimin e trajtimit në një strukturë të përshtatshme, kur gjendja e pacientit kërkon ndërhyrje ose trajtim të specializuar që tejkalon

kapacitetet e qendrës së hemodializës. Kërkesa për paraqitjen e deklaratës nga operatori ekonomik synon të garantojë angazhimin e tij për të disponuar gjatë gjithë periudhës së kontratës personelin, pajisjet dhe barnat e nevojshme për reagimin fillestar ndaj situatave emergjente, si dhe për të zbatuar procedurat e përcaktuara për referimin e pacientëve.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratë/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me një subjekt të specializuar dhe të autorizuar për ofrimin e shërbimit “backup” të hemodializës, në rast defekti ose mosfunksionimi të përkohshëm të pajisjeve, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së trajtimit të pacientëve gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Nëpërmjet kërkesës ndaj operatorëve ekonomikë ofertues për të paraqitur një kontratë/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me një subjekt të specializuar dhe të autorizuar për ofrimin e shërbimit “backup” të hemodializës, bëhet e mundur garantimi i vazhdimësisë së trajtimit të pacientëve në rast të defektit, avarisë ose mosfunksionimit të përkohshëm të pajisjeve të nevojshme për realizimin e shërbimit. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me ofrimin e shërbimit të hemodializës, i cili është një shërbim shëndetësor i specializuar dhe i vazhdueshëm, ndërprerja ose pamundësia e përkohshme për të realizuar një seancë të planifikuar mund të ndikojë në vijimësinë e trajtimit të pacientëve. Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë një mekanizëm të paracaktuar për sigurimin e shërbimit alternativ në rast të situatave teknike që pengojnë realizimin e seancave në qendrën përkatëse. Kërkesa për lidhjen e një kontrate/marrëveshjeje bashkëpunimi me një subjekt të specializuar dhe të autorizuar synon të garantojë se, në rast të një defekti ose mosfunksionimi të përkohshëm të pajisjeve, ekziston një strukturë alternative e identifikuar dhe e gatshme për të marrë përsipër ofrimin e shërbimit të hemodializës, në përputhje me kërkesat profesionale, teknike dhe ligjore në fuqi. Subjekti i angazhuar për ofrimin e shërbimit “backup” duhet të disponojë kapacitetet e nevojshme profesionale, teknike dhe organizative për të realizuar trajtimin e pacientëve në kushte të përshtatshme, duke përfshirë pajisjet, personelin dhe infrastrukturën e nevojshme për ofrimin e shërbimit të hemodializës. Kontrata/marrëveshja e bashkëpunimit shërben si dëshmi se kjo mundësi alternative nuk është thjesht një angazhim i përgjithshëm i operatorit ekonomik, por është e mbështetur në një marrëdhënie konkrete dhe të vlefshme me një subjekt që mund të ofrojë shërbimin në rast nevojë. Kjo i mundëson Autoritetit Kontraktor të verifikojë paraprakisht ekzistencën e një mekanizmi të besueshëm për vazhdimin e trajtimit të pacientëve. Kërkesa është përcaktuar gjithashtu duke marrë në konsideratë nevojën për minimizimin e riskut të ndërprerjes së shërbimit për shkak të defekteve teknike, avarive ose situatave të tjera të paparashikuara që mund të ndikojnë në funksionimin e pajisjeve të hemodializës. Disponimi i një zgjidhjeje alternative të organizuar paraprakisht mundëson reagim më të shpejtë dhe redukon kohën gjatë së cilës pacientët mund të mbeten pa shërbimin e planifikuar.

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një Projekt Teknik për organizimin dhe vijimin e shërbimit të hemodializës, i cili duhet të përmbajë mënyrën e organizimit të shërbimit, garantimin e vazhdimësisë së trajtimeve, organizimin e burimeve njerëzore dhe masave të propozuara për cilësinë dhe sigurinë e shërbimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke marrë në konsideratë natyrën e specializuar, kompleksitetin dhe karakterin e vazhdueshëm të shërbimit të hemodializës. Nëpërmjet kërkesës ndaj operatorëve ekonomikë ofertues për të paraqitur një Projekt Teknik për organizimin dhe vijimin e shërbimit të hemodializës, bëhet e mundur që Autoriteti Kontraktor të vlerësojë paraprakisht mënyrën konkrete të organizimit dhe realizimit të shërbimit, si dhe masat e propozuara nga operatori ekonomik për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Duke qenë se shërbimi i hemodializës është një shërbim shëndetësor i specializuar dhe i vazhdueshëm, i cili kërkon realizimin e trajtimeve të planifikuara në mënyrë periodike, është e domosdoshme që operatori ekonomik të paraqesë një mënyrë të qartë dhe të strukturuar të organizimit të shërbimit, në mënyrë që të garantohet realizimi i seancave sipas planifikimit dhe kërkesave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. Projekti Teknik duhet të përmbajë mënyrën e organizimit të shërbimit, duke përshkruar organizimin e proceseve të punës, koordinimin e aktiviteteve, mënyrën e funksionimit të qendrave të hemodializës dhe ndërveprimin ndërmjet personelit mjekësor, infermieror, teknik dhe personelit tjetër të angazhuar në ofrimin e shërbimit. Kjo kërkesë synon të sigurojë që operatori ekonomik të ketë një planifikim të qartë dhe të realizueshëm për ofrimin e shërbimit. Një element i rëndësishëm i Projektit Teknik është garantimi i vazhdimësisë së trajtimeve. Për shkak të natyrës së trajtimit të pacientëve me hemodializë, ndërprerja ose shtyrja e seancave të planifikuara duhet të shmanget sa më shumë të jetë e mundur. Për këtë arsye, operatori ekonomik duhet të përcaktojë masat organizative dhe teknike që do të ndërmarrë në rast të mungesës së personelit, defekteve të pajisjeve, ndërprerjeve të shërbimeve mbështetëse, situatave emergjente apo rrethanave të tjera që mund të ndikojnë në vijimësinë e shërbimit. Projekti Teknik duhet të përmbajë gjithashtu mënyrën e organizimit të burimeve njerëzore, duke përcaktuar strukturën dhe shpërndarjen e personelit të nevojshëm, funksionet dhe përgjegjësitë e tij, mënyrën e mbulimit të shërbimit dhe masat për zëvendësimin e personelit në rast mungese. Kjo synon të garantojë që gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës të ketë në dispozicion burimet njerëzore të nevojshme për realizimin e shërbimit në mënyrë të vazhdueshme dhe cilësore. Gjithashtu, në Projektin Teknik operatori ekonomik duhet të përshkruajë masat e propozuara për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimit, duke përfshirë procedurat e monitorimit dhe kontrollit të procesit të punës, masat për menaxhimin e situatave emergjente, masat për parandalimin dhe menaxhimin e riskut, si dhe mënyrën e evidentimit dhe trajtimit të problematikave që mund të shfaqen gjatë ofrimit të shërbimit. Kërkesa për paraqitjen e Projektit Teknik i mundëson Autoritetit Kontraktor të vlerësojë në mënyrë të strukturuar nëse operatori ekonomik ka një qasje të qartë, të organizuar dhe të realizueshme për përmbushjen e objektit të kontratës. Përmbajtja e Projektit Teknik është e lidhur drejtpërdrejt me kërkesat e shërbimit dhe me rezultatet që Autoriteti Kontraktor synon të garantojë gjatë zbatimit të kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Ne rast të paraqitjes së ofertave nga operatorët ekonomik të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoriteteve kontraktore për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike dhe termat e referencës janë përcjellë pranë OSHIS sha, të hartuara nga grupi e punës i caktuar nga titullari e AK, bazuar në nevojat e të cilës, Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit sh.a kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, Vendimit Nr. 845, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave *“Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” Sha (Oshis Sh.a.) për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit”*, ndryshuar me Vendimit nr. 629, datë 30.07.2026 të Këshillit të Ministrave *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimit Nr. 845, datë 30.12.2025, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë aksionare “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” sha (OSHIS sh.a.) për ofrimin e shërbimeve të integruara të procesit të sterilizimit”, në pikën 1, është ndryshuar si më poshtë vijon: “I. Krijimin e Shoqërisë aksionare “Operatori i Shërbimeve të Integruara të Shëndetësore” sh.a (OSHISH sh.a), me kapital 100% shtetëror, për ofrimin e shërbimeve të integruara të sterilizimit, organizimin, administrimin dhe ofrimin e shërbimeve të Programit Kombëtar të Kontrollit Mjekësor Bazë, si dhe ofrimin e shërbimit të hemodializës në 5 (pesë) qendra pranë Spitaleve Shkodër, Lezhë, Vlorë Elbasan dhe Korçë.”*

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit, në përputhje me nenin 36 të ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar si dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor. Specifikimet Teknike janë hartuar në mënyrë që të përcaktojnë nivelin optimal të kërkuar të shërbimit dhe të performancës, duke përcaktuar kërkesat e nevojshme për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së tij, pa krijuar kufizime të pajustificuara për konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor.

➤ SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimet Teknike janë hartuar në mënyrë që të përcaktojnë nivelin optimal të kërkuar të shërbimit dhe të performancës, duke përcaktuar kërkesat e nevojshme për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së tij, pa krijuar kufizime të pajustificuara për konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë. Në rastet kur kërkesat mund të përmbushen nëpërmjet zgjidhjeve të ndryshme teknike ose teknologjike, do të pranohen zgjidhje ekuivalente, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Pajisjet, aparaturat mjekësore, sistemet, ambientet dhe infrastruktura ekzistuese që do të vihen në dispozicion të Operatorit Ekonomik nga Autoriteti Kontraktor do të përdoren dhe administrohen në përputhje me statusin e tyre dhe dokumentacionin teknik përkatës. Operatori ekonomik është përgjegjës për sigurimin, testimin dhe mirëmbajtjen periodike të gjeneratorit, UPS-it, stabilizatorëve dhe ndriçimit të emergjencës.

Pajisjet, materialet, burimet njerëzore dhe organizative, si dhe çdo element tjetër i nevojshëm për realizimin e shërbimeve laboratorike që nuk vihen në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, do të sigurohen nga Operatori Ekonomik.

➤ **PAJISJET LABORATORIKE DHE EKZAMINIMET PER MONITORIMIN E PACIENTËVE**

Në funksion të ofrimit të shërbimit të hemodializës, **Operatori Ekonomik është përgjegjës për organizimin dhe realizimin e të gjitha analizave laboratorike të nevojshme, sipas protokolleve të miratuara për këtë shërbim.** Operatori Ekonomik duhet të sigurojë pajisjet, aparaturat, personelin, reagentët, materialet e konsumit dhe çdo burim tjetër të nevojshëm ose të organizojë kryerjen e tyre pranë një laborator apo strukture laboratorike të përshtatshme dhe të akredituar për këtë qëllim.

Operatori Ekonomik është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit laboratorik, duke përfshirë, sipas rastit, marrjen, identifikimin, ruajtjen dhe transportin e mostrave, kryerjen e analizave, administrimin e rezultateve dhe dokumentimin e tyre, si dhe për garantimin e **saktësisë, besueshmërisë, cilësisë dhe gjurmueshmërisë** së rezultateve. Për këtë qëllim, duhet të sigurojë personel të kualifikuar dhe të zbatojë kërkesat profesionale dhe ligjore të zbatueshme.

Operatori Ekonomik duhet të mbajë **evidenca të dokumentuara dhe të gjurmueshme** për analizat e kryera, datën e realizimit, rezultatet, kontrollet e cilësisë, të dhëna të cilat duhet të jenë të disponueshme për Autoritetin Kontraktor gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe kontratë.

- Ekzaminimet laboratorike dhe diagnostike

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë kryerjen e ekzaminimeve laboratorike dhe diagnostike të nevojshme për **ndjekjen, monitorimin dhe vlerësimin periodik të pacientëve që trajtohen me hemodializë**, në përputhje me legjislacionin në fuqi, protokollat mjekësore të miratuara dhe kërkesat profesionale të zbatueshme.

Në zbatim të Vendimit Nr. 308, datë 21.05.2014, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e paketave të shërbimeve shëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Shërbimin Spitalor”, i ndryshuar me Vendimin Nr. 373, datë 26.04.2017, të Këshillit të Ministrave dhe Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë Nr. 326, datë 19.07.2017 “Për miratimin e protokolleve mjekësore të realizimit të paketave të shërbimit që financohen nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si dhe akteve që

mund t'i ndryshojnë ose zëvendësojnë ato, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë, të paktën, ekzaminimet e mëposhtme:

a) Çdo muaj:

- azotemi dhe kreatinemi para dhe pas seancës së hemodializës;
- kalemi para dhe pas seancës;
- natremi, kalcemi dhe fosforemi;
- ALT dhe glicemi;
- proteina totale dhe albuminemi;
- gjak komplet;
- bikarbonat venoz;
- llogaritja e Kt/V dhe URR.

b) Çdo 3 muaj:

- HBsAg, HBsAb dhe Anti-HCV;
- sideremi, kapaciteti lidhës i hekurit dhe ferritina;
- acid urik dhe CRP;
- HbA1c për pacientët diabetikë.

c) Çdo 6 muaj:

- PTH;
- HIV;
- EKG.

d) Një herë në vit:

- HBsAg, HBsAb dhe Anti-HCV, sipas metodës dhe protokollit të aplikueshëm, për pacientët me teste virale pozitive;
- grafi të kockave, sipas indikacionit mjekësor;
- ekokardiografi;
- eko abdominale;
- vitaminë D25 (OH).

Periodiciteti i mësipërm përbën nivelin minimal të kërkuar të shërbimit. Kur gjendja klinike e pacientit, indikacioni mjekësor, protokollet përkatëse ose kuadri rregullator kërkojnë ekzaminime shtesë apo kryerjen e tyre me frekuencë më të madhe, Operatori Ekonomik duhet t'i sigurojë ato në përputhje me kërkesat mjekësore dhe kushtet e kontratës.

- Indekset dhe parametrat e monitorimit të pacientëve.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë monitorimin periodik dhe dokumentimin e parametrave biokimikë, hematologjikë dhe klinikë të pacientëve që trajtohen me hemodializë.

Rezultatet e ekzaminimeve duhet të dokumentohen në mënyrë të gjurmueshme dhe të përdoren nga ekipi mjekësor për vlerësimin e përshtatshmërisë të trajtimit, gjendjes ushqyese, kontrollit të anemisë, statusit mineral-kockor dhe faktorëve të tjerë klinikë të pacientit.

Parametrat kryesorë që duhet të monitorohen dhe raportohen periodikisht përfshijnë:

Emri i testit	Çfarë vlerëson testi	Targeti i rekomanduar
Kt/V	Doza e dializës	Së paku 1.2 për çdo seancë hemodialize
URR (hemodializë)	Doza e dializës	Së paku 65% për çdo seancë HD
Hemoglobina	Kontrolli i anemisë	≥ 10.5 g/dl dhe ≤ 12.5 g/dl
Ferritina serike	Depot e hekurit në organizëm	Së paku 200 (HD); së paku 110 (DP)
Saturimi i transferrinës	Depot e hekurit në organizëm	Së paku 20%
Albuminemia	Statusi nutricional	≥ 4 g/dl
Fosfori	Shëndetin e kockave dhe vazave	3.5-5.5 mg/dl
Kalciumi	Shëndetin e kockave dhe vazave	8.4-9.5 mg/dl
Kolesterol total	Shëndetin kardiovaskular	≤ 200 mg/dl
LDL kolesterol	Shëndetin kardiovaskular	≤ 100 mg/dl

HDL kolesteroli	Shëndetin kardiovaskular	≥ 40 mg/dl
Trigliceridet	Shëndetin kardiovaskular	≤ 150 mg/dl
Përqëndrimi pre- dialitik i bikarbonateve serike	Shëndetin kardial dhe kockor	18-24 mmol/l

Ekzaminimet biokimike dhe imunologjike

Operatori Ekonomik është përgjegjës për garantimin e realizimit të **të gjitha ekzaminimeve biokimike dhe imunologjike** të nevojshme për ndjekjen dhe monitorimin periodik të pacientëve që trajtohen me hemodializë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Specifikimet Teknike, kontratë dhe protokollet mjekësore të zbatueshme.

Ekzaminimet duhet të kryhen **brenda periodicitetit dhe afateve të përcaktuara**, me saktësi, besueshmëri dhe cilësi të përshtatshme, nëpërmjet mjeteve, pajisjeve dhe/ose strukturave laboratorike të përshtatshme, në përputhje me kërkesat ligjore dhe profesionale në fuqi.

Dokumentacioni dhe menaxhimi i ekzaminimeve laboratorike

Operatori Ekonomik duhet të administrojë, përditësojë dhe ruajë dokumentacionin lidhur me ekzaminimet laboratorike të kryera gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, duke garantuar gjurmueshmërinë, transparencën dhe verifikueshmërinë e tyre.

Dokumentacioni duhet të mundësojë identifikimin e analizës, datën e kryerjes, rezultatin përkatës dhe, sipas rastit, mjetin, pajisjen ose strukturën laboratorike nëpërmjet të cilës është realizuar. Në rast ndryshimi të mënyrës së organizimit të shërbimit ose të mjeteve dhe strukturave të përdorura, dokumentacioni duhet të përditësohet përkatësisht.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë që ekzaminimet të realizohen nëpërmjet mjeteve, pajisjeve dhe/ose strukturave laboratorike të përshtatshme dhe të vlefshme, në përputhje me kërkesat ligjore, profesionale dhe teknike në fuqi.

Dokumentacioni përkatës duhet t'i vihet në dispozicion Autoritetit Kontraktor, me qëllim monitorimi dhe verifikimi të realizimit të analizave dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore. Menaxhimi dhe ruajtja e këtij dokumentacioni, si dhe garantimi i vijimësisë së ekzaminimeve laboratorike, janë përgjegjësi e Operatorit Ekonomik gjatë gjithë periudhës së kontratës.

➤ AMBIENTET, INFRASTRUKTURA DHE INSTALIMET

Shërbimi i hemodializës do të ofrohet në **5 (pesë) qendra**, përkatësisht në institucionet spitalore Shkodër, Lezhë, Elbasan, Vlorë dhe Korçë. Ambientet, infrastruktura dhe instalimet ekzistuese të këtyre qendrave do t'i vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik për realizimin e shërbimit, i cili duhet t'i përdorë ato sipas destinacionit dhe në përputhje me kërkesat teknike, funksionale, higjieno-sanitare dhe të sigurisë.

Operatori Ekonomik është i detyruar të përballojë dhe të shlyejë të gjitha detyrimet financiare që rrjedhin nga përdorimi i ambienteve të vëna në dispozicion për shërbimin objekt kontrate, përfshirë pagesën e qirasë, si dhe shpenzimet për konsumimin e energjisë elektrike, ujit dhe çdo shërbimi tjetër utilitar të lidhur me përdorimin e këtyre ambienteve, sipas matjeve dhe/ose faturave përkatëse. Operatori Ekonomik mban përgjegjësi për pagesën e këtyre detyrimeve gjatë gjithë periudhës së përdorimit të ambienteve.

Gjatë zbatimit të kontratës, Operatori Ekonomik është përgjegjës për përdorimin e kujdesshëm të ambienteve dhe instalimeve, ruajtjen e kushteve të përshtatshme të funksionimit dhe njoftimin pa vonesë të Autoritetit Kontraktor për çdo defekt, problem ose parregullsi që mund të çojë në sigurinë e pacientëve dhe personelit apo vazhdimësinë e shërbimit.

➤ **KAPACITETI I QENDRAVE DHE ORGANIZIMI I SHËRBIMIT**

Kapaciteti i secilës qendër të hemodializës përcaktohet në funksion të nevojave të Autoritetit Kontraktor dhe karakteristikave konkrete të qendrës, duke marrë në konsideratë numrin e posteve të hemodializës, pacientëve dhe trajtimeve të planifikuara, numrin dhe orarin e turneve, kapacitetin e pajisjeve dhe të sistemit të trajtimit të ujit, ambientet dhe nevojat për personel, si dhe kërkesat e tjera teknike specifike të qendrës. Për qëllime të ofrimit të këtij shërbimi, kapaciteti fizik i qendrave, i përcaktuar në bazë të numrit të poltronave të hemodializës në dispozicion, është: 32 pajisje hemodialize në Qendrën e Hemodializës Shkodër, 21 pajisje hemodialize në Qendrën e Hemodializës Lezhë, nga 44 pajisje hemodialize në Qendrën e Hemodializës Elbasan, nga 21 pajisje hemodialize në Qendrën e Hemodializës Vlorë dhe nga 38 pajisje hemodialize në Qendrën e Hemodializës Korçë, për një kapacitet total 156 pajisje hemodialize.

Operatori Ekonomik duhet të organizojë dhe realizojë shërbimin në përputhje me kapacitetin e përcaktuar për secilën qendër, duke siguruar të gjitha burimet njerëzore, teknike dhe organizative të nevojshme për realizimin e trajtimeve të planifikuara në jo më pak se 2 (dy) turne pune në ditë, sipas nevojave dhe planifikimit të shërbimit, me përjashtim të turnit të natës. Organizimi i shërbimit dhe përdorimi i kapaciteteve të çdo qendre duhet të bëhet në përputhje me numrin e pacientëve, frekuencën e trajtimeve, orarin e shërbimit dhe kapacitetin e poltronave në dispozicion.

➤ **PERSONELI DHE ORGANIZIMI OPERACIONAL**

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës personelin mjekësor, infermieror, teknik dhe mbështetës të nevojshëm për ofrimin e vazhdueshëm, të sigurt dhe cilësor të shërbimit të hemodializës. Personeli duhet të jetë i kualifikuar për pozicionin

përkatës, të përmbushë kërkesat ligjore dhe profesionale për ushtrimin e profesionit dhe, kur kërkohet, të jetë i pajisur me licencën ose autorizimin përkatës.

Operatori Ekonomik është përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë së personelit mjekësor, infermieror, teknik, laboratorik dhe mbështetës, si dhe për organizimin e proceseve operative të nevojshme për ofrimin e sigurt, efektiv dhe të pandërprerë të shërbimit, në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Numri dhe organizimi i personelit duhet të përshtaten me numrin e posteve, pacientëve, turneve, orarit të funksionimit dhe volumit të trajtimeve për secilën qendër, duke garantuar mbulimin e plotë të shërbimit gjatë gjithë orarit të përcaktuar.

Në mënyrë minimale, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë:

1. **5 (pesë) mjekë nefrologë**, me përvojë profesionale jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën përkatëse. Për secilin duhet të paraqitet kontratë individuale pune/shërbimi ose marrëveshje bashkëpunimi e vlefshme, si dhe dokumentacioni që provon diplomimin, përvojën dhe licencimin profesional.
2. **1 (një) infermier për çdo 4 (katër) pacientë në turn**, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në ofrimin e shërbimit të hemodializës. Për personelin infermieror duhet të paraqitet dokumentacioni përkatës që provon marrëdhënien kontraktore, kualifikimin, licencimin, trajnimin në hemodializë dhe përvojën profesionale.

Ekip multidisciplinar mbështetës për çdo qendër, me kontratë me kohë të pjesshme, sipas specialiteteve:

- Mjek kardiolog;
- Psikolog;
- Dietolog/nutricionist;
- Reanimator.

Operatori Ekonomik duhet të garantojë që personeli i angazhuar të jetë **i disponueshëm gjatë gjithë periudhës së kontratës** dhe të sigurojë zëvendësimin e menjëhershëm të çdo punonjësi që mungon, largohet ose nuk mund të ushtrojë detyrën, në mënyrë që të mos cenohet vazhdimësia dhe cilësia e shërbimit.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë që personeli i angazhuar në ofrimin e shërbimit të përmbushë të gjitha kërkesat ligjore dhe profesionale përkatëse. Për çdo anëtar të personelit duhet të disponohet dokumentacioni që provon, sipas rastit, kualifikimin profesional, licencimin, certifikimet dhe trajnimet përkatëse. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm dhe i përditësuar gjatë gjithë periudhës së ofrimit të shërbimit.

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë trajnimin periodik të personelit të angazhuar në ofrimin e shërbimit, në funksion të garantimit të realizimit të sigurt dhe cilësor të tij. Trajnimi duhet të

përfshijë, sipas nevojës, përdorimin e pajisjeve të hemodializës, sistemin e trajtimit të ujit, procedurat operative, masat e sigurisë, procedurat e emergjencës, si dhe çdo element tjetër të nevojshëm për ofrimin e shërbimit. Trajnime shtesë duhet të organizohen në rast të instalimit të pajisjeve të reja, ndryshimit të metodologjisë së punës, përditësimit të sistemeve ose ndryshimeve të tjera teknike që ndikojnë në mënyrën e ofrimit të shërbimit. Trajnimet duhet të dokumentohen, duke evidentuar të paktën datën, përmbajtjen dhe personat pjesëmarrës.

Operatori Ekonomik duhet të garantojë vazhdimësinë e personelit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës dhe të sigurojë zëvendësimin e menjëhershëm të çdo punonjësi që mungon përkohësisht ose largohet nga shërbimi. Personeli zëvendësues duhet të përmbushë të njëjtat kërkesa profesionale, të kualifikimit dhe, sipas rastit, të licencimit të përcaktuara për pozicionin përkatës, në mënyrë që mungesa ose zëvendësimi i personelit të mos çenojë sigurinë, cilësinë dhe vazhdimësinë e shërbimit.

Për garantimin e vijimësisë së shërbimit, Operatori Ekonomik duhet të disponojë, në momentin e ofertimit dhe gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, kontratë ose marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me një operator ekonomik të licencuar dhe të autorizuar për ofrimin e transportit mjekësor me autoambulancë, për rastet kur ky shërbim nevojitet gjatë ofrimit të hemodializës.

➤ **MIRËMBAJTJA, KALIBRIMI, ASISTENCA TEKNIKE DHE PAJISJET ZËVENDËSUESE**

Operatori Ekonomik është përgjegjës, gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, për **mirëmbajtjen preventive dhe korigjuese, kalibrimin, kontrollet dhe verifikimet teknike, riparimin dhe asistencën teknike** për pajisjet, aparaturat dhe sistemet e përdorura për realizimin e shërbimit, në përputhje me dokumentacionin teknik, kërkesat e prodhuesit dhe kushtet e kontratës.

Për pajisjet dhe sistemet e vëna në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor, gjendja teknike dhe funksionale do të evidentohet në dokumentacionin e marrjes në dorëzim. Operatori Ekonomik duhet të sigurojë të gjitha burimet e nevojshme për mirëmbajtjen, riparimin dhe rikthimin në funksion të tyre, përfshirë **personelin teknik kompetent, pjesët e këmbimit, materialet, mjetet dhe asistencën teknike**.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontratë/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me një subjekt të specializuar dhe të autorizuar për mirëmbajtjen, servisimin dhe asistencën teknike të pajisjeve të hemodializës, të modelit Surdial 55 Plus dhe Surdial X, me qëllim garantimin e funksionimit të tyre gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Operatori Ekonomik duhet të **dokumentojë dhe të mbajë të përditësuar evidencën e defekteve dhe ndërhyrjeve teknike**, duke përfshirë, sipas rastit, pajisjen ose sistemin e prekur, natyrën e defektit, masat e ndërmarra, riparimet ose zëvendësimet e kryera, përdorimin e pajisjeve zëvendësuese dhe kohën e rikthimit në funksion. Ky dokumentacion duhet të jetë i gjurmueshëm

gjatë gjithë periudhës së kontratës dhe t'i vihet në dispozicion Autoritetit Kontraktor, me kërkesë të tij, për qëllime monitorimi dhe verifikimi të zbatimit të kontratës.

Për garantimin e vazhdimësisë së shërbimit, Operatori Ekonomik duhet të disponojë **kontratë/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme gjatë gjithë periudhës së kontratës, me një subjekt të specializuar dhe të autorizuar për sigurimin e shërbimit “backup” të hemodializës.**

Operatori Ekonomik duhet të trajtojë mbetjet spitalore të gjeneruara gjatë ofrimit të shërbimit të hemodializës, dhe për këtë duhet të jetë i pajisur me licencat/autorizimet përkatëse ose, në alternativë, të disponojë kontratë/marrëveshje bashkëpunimi të vlefshme me subjekt të licensuar/autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për trajtimin e mbetjeve.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë kapacitetet profesionale dhe teknike për mirëmbajtjen dhe servisimin e sistemit të trajtimit dhe parafiltrimit të ujit ose, në alternativë, të disponojë një kontratë/marrëveshje bashkëpunimi me një operator ekonomik të specializuar dhe të licensuar/autorizuar, sipas legjislacionit në fuqi.

TERMAVE TË REFERENCËS

1. Objekti i shërbimit

Objekti i kësaj procedure prokurimi është **ofrimi i shërbimit të hemodializës për pacientët me insuficiencë renale kronike**, në 5 (pesë) qendrat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, për një numër të përafërt prej 556 pacientësh.

Shërbimi do të ofrohet në ambientet ekzistuese të këtyre qendrave dhe me përdorimin e pajisjeve, aparaturave dhe sistemeve që do t'i vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik nga Autoriteti Kontraktor, sipas përcaktimeve të dokumenteve të tenderit dhe dokumentacionit të marrjes në dorëzim.

Operatori Ekonomik do të përdorë, ndër të tjera, aparaturat e hemodializës **Surdial 55 Plus** dhe **Surdial X**, si dhe pajisjet dhe sistemet e tjera të përcaktuara në dokumentet e procedurës.

Qëllimi i kontratës është **garantimi i vazhdimësisë, cilësisë dhe sigurisë së trajtimit të pacientëve**, në përputhje me gjendjen e tyre klinike, protokollet mjekësore, kërkesat profesionale dhe legjislacionin në fuqi.

2. Përshkrimi i shërbimit

Operatori Ekonomik është përgjegjës për **organizimin dhe realizimin e shërbimit të hemodializës**, duke siguruar personelin dhe burimet e nevojshme për funksionimin e qendrave dhe realizimin e trajtimeve të planifikuara.

Shërbimi do të ofrohet nën përgjegjësinë profesionale të mjekëve nefrologë dhe nga personel i kualifikuar, i licensuar dhe i trajnuar, sipas kërkesave të përcaktuara në Specifikimet Teknike dhe legjislacionin në fuqi.

Trajtimi i çdo pacienti do të kryhet në përputhje me vlerësimin mjekësor dhe parametrat individualë të trajtimit, duke respektuar protokollet dhe udhërrëfyesit e praktikës klinike të zbatueshme.

Operatori Ekonomik duhet të garantojë monitorimin e pacientit para, gjatë dhe pas seancës së hemodializës, si dhe dokumentimin e të dhënave klinike dhe të shërbimeve të ofruara, në përputhje me kërkesat profesionale dhe ligjore.

3. Burimet që siguron Autoriteti Kontraktor

Autoriteti Kontraktor do t'i vërë në dispozicion Operatorit Ekonomik **ambientet, pajisjet, aparaturat dhe sistemet ekzistuese** të nevojshme për realizimin e shërbimit.

Dorëzimi dhe marrja në përdorim do të dokumentohen nëpërmjet procesverbalit të marrjes në dorëzim, inventarit dhe/ose dokumentacionit tjetër përkatës, ku do të evidentohen gjendja dhe karakteristikat e aseteve të vëna në dispozicion.

Operatori Ekonomik nuk mund t'i përdorë këto asete për qëllime të ndryshme nga realizimi i objektit të kontratës dhe duhet t'i përdorë ato në përputhje me destinacionin, dokumentacionin teknik, udhëzimet e prodhuesit dhe kërkesat e sigurisë.

4. Detyrimet e Operatorit Ekonomik

Operatori Ekonomik do të sigurojë, me shpenzimet e veta, të gjitha burimet dhe elementet e nevojshme për realizimin e shërbimit që nuk janë përcaktuar si burime të vëna në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik do të sigurojë personelin mjekësor, infermieror, teknik dhe mbështetës, materialet mjekësore dhe konsumuese, barnat dhe materialet e nevojshme për menaxhimin e situatave emergjente, ekzaminimet laboratorike dhe diagnostike, si dhe çdo burim tjetër të përcaktuar në protokollet e miratuara nga organet kompetente për këtë shërbim.

Operatori Ekonomik është përgjegjës për organizimin e punës dhe mbulimin e mungesave të përkohshme të personelit, në mënyrë që të garantohet realizimi i shërbimit sipas kapaciteteve dhe orareve të përcaktuara për secilën qendër.

Në funksion të administrimit, monitorimit dhe dokumentimit të shërbimit, Operatori Ekonomik duhet të sigurojë disponueshmërinë dhe përdorimin e sistemeve të avancuara dixhitale për menaxhimin dhe dokumentimin e shërbimit të hemodializës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Specifikimet Teknike dhe kontratë.

5. Pajisjet e hemodializës

Pajisjet e hemodializës të vëna në dispozicion nga Autoriteti Kontraktor do të përdoren nga Operatori Ekonomik për realizimin e shërbimit, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe kërkesat e prodhuesit.

Operatori Ekonomik është përgjegjës për **mirëmbajtjen preventive dhe korrigjuese, kalibrimin, kontrollet teknike, riparimin dhe asistencën teknike** për këto pajisje gjatë gjithë periudhës së kontratës, sipas kërkesave të përcaktuara në Specifikimet Teknike.

Për mirëmbajtjen dhe asistencën teknike të aparaturave, Operatori Ekonomik duhet të disponojë kapacitetet e nevojshme ose të sigurojë këto shërbime nëpërmjet një subjekti të specializuar dhe të autorizuar, sipas kërkesave të dokumenteve të tenderit.

Në rast defekti ose mosfunksionimi të pajisjeve që mund të ndikojë në vazhdimësinë e trajtimit, Operatori Ekonomik duhet të marrë masat e nevojshme për rikthimin e tyre në funksion, brenda 24 orëve nga moment i konstatimit të defektit, dhe, kur kjo nuk është e mundur brenda këtij afati, të sigurojë **pajisje zëvendësuese, pajisje rezervë ose zgjidhje teknike të barasvlershme**, sipas kërkesave të kontratës.

6. Siguria dhe cilësia e shërbimit

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë shërbimin në përputhje me kërkesat **mjekësore, profesionale, higjieno-sanitare dhe të sigurisë**, si dhe me kërkesat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve.

Gjatë ofrimit të shërbimit duhet të zbatohen procedurat për higjienën, dezinfektimin, përdorimin e sigurt të materialeve mjekësore, menaxhimin e materialeve të kontaminuara dhe mbrojtjen e pacientëve dhe personelit.

Operatori Ekonomik duhet të ketë kapacitetet profesionale dhe organizative për menaxhimin e komplikacioneve dhe situatave emergjente gjatë seancave të hemodializës dhe, kur kërkohet, të sigurojë referimin dhe/ose transportimin e pacientit në strukturën shëndetësore përkatëse.

Në ofrimin e shërbimit duhet të respektohen gjithashtu aktet normative të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, udhërrëfyesit dhe protokollet e praktikës klinike të miratuara, si dhe Kodi i Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore.

Operatori Ekonomik duhet të **zbatojë protokollet mjekësore të miratuara për cilësinë e shërbimit**, me qëllim garantimin e sigurisë së pacientëve, cilësisë së trajtimit, funksionalitetit të pajisjeve dhe vazhdimësisë së shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, si dhe në përmbushje të detyrimeve kontraktore.

Autoriteti Kontraktor do të monitorojë **performancën e shërbimit, përmbushjen e kërkesave teknike dhe profesionale, treguesit përkatës të trajtimit, funksionalitetin e pajisjeve dhe sistemeve, si dhe respektimin e kërkesave të sigurisë dhe kontrollit të infeksioneve**.

Në rast konstatimi të devijimeve, mangësive ose problematikave që mund të ndikojnë në cilësinë, sigurinë ose vazhdimësinë e shërbimit, Operatori Ekonomik duhet të **marrë menjëherë masat korrigjuese dhe parandaluese të nevojshme** dhe të dokumentojë veprimet e ndërmarra.

7. Mbetjet mjekësore dhe dezinfektimi

Operatori Ekonomik është përgjegjës për **menaxhimin e mbetjeve mjekësore** të gjeneruara nga ofrimi i shërbimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menaxhimi përfshin ndarjen, grumbullimin, ruajtjen dhe trajtimin e mbetjeve, sipas rastit, nëpërmjet kapaciteteve të veta ose subjekteve të autorizuar të kontraktuara për këtë qëllim.

Operatori Ekonomik është gjithashtu përgjegjës për dezinfektimin e ambienteve dhe pajisjeve të përdorura gjatë ofrimit të shërbimit, në përputhje me kërkesat teknike dhe higjieno-sanitare të zbatueshme.

8. Vazhdimësia e shërbimit

Operatori Ekonomik duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për **garantimin e vazhdimësisë së shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës**, në përputhje me kapacitetet dhe planifikimin e përcaktuar për secilën qendër.

Mungesa e përkohshme e personelit, defektet e pajisjeve ose rrethana të tjera operative nuk duhet të çënojnë sigurinë e pacientëve apo të shkaktojnë ndërprerje të pajustificuara të trajtimit. Operatori Ekonomik duhet të sigurojë organizimin e përshtatshëm të personelit, kapaciteteve teknike dhe burimeve të tjera, si dhe zgjidhjet alternative të përcaktuara në Specifikimet Teknike.

9. Dokumentimi dhe raportimi

Operatori Ekonomik duhet të **mbajë dhe administrojë dokumentacionin mjekësor, teknik dhe administrativ** të nevojshëm për evidentimin dhe verifikimin e shërbimit të ofruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Për çdo pacient duhet të mbahet kartela mjekësore përkatëse, ku dokumentohen shërbimet e ofruara, ekzaminimet dhe rezultatet e tyre, parametrat e trajtimit, komplikacionet dhe ndërhyrjet e kryera, sipas kërkesave profesionale dhe ligjore. Për çdo shërbim të kryer duhet të mbahet edhe evidenca përkatëse e konfirmimit nga pacienti ose kujdestari, sipas formatit (pasqyra) të miratuar për këtë qëllim.

Operatori Ekonomik duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor, sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara në kontratë, informacionet dhe raportet periodike mbi pacientët, trajtimet e kryera dhe treguesit e tjerë të kërkuar.

Operatori Ekonomik duhet të ruajë dokumentacionin mjekësor dhe ekonomik-financiar për periudhën e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe ta vërë atë në dispozicion të Autoritetit Kontraktor për qëllime kontrolli dhe verifikimi.

10. Kontrolli dhe monitorimi

Autoriteti Kontraktor do të monitorojë dhe kontrollojë realizimin e shërbimit gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tij me **Termat e Referencës, Specifikimet Teknike dhe kushtet kontraktore**.

Operatori Ekonomik është i detyruar të bashkëpunojë me Autoritetin Kontraktor dhe të vërë në dispozicion, sipas kërkesës, dokumentacionin, të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për kontrollin dhe verifikimin e realizimit të shërbimit.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë kontrolle pranë qendrave të hemodializës dhe të verifikojë përmbushjen e detyrimeve kontraktore, përfshirë cilësinë, sasinë, vazhdimësinë dhe përputhshmërinë e shërbimit me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e procedurës.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

1. Spitali Rajonal Shkodër
2. Spitali Rajonal Lezhë
3. Spitali Rajonal Korçë
4. Spitali Rajonal Vlorë
5. Spitali Rajonal Elbasan

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të shërbimeve dhe mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

NJËSIA E PROKURIMIT